

From: rezana celmeta
Sent: Monday, March 13, 2017 3:34 PM
To: Inva Hasanaliaj
Cc: Anisa Pina
Subject: RE: Kerkese per informacion

E nderuar znj.Hasanaliaj,

Në lidhje me kërkesën tuaj për Informacion, përcjellë me email nga znj.Anisa Pina, Specialiste në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, në adresën e koordinatores për të Drejtën e Informimit në DPT, datë 1.3.2017, bazuar në ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e Informimit", regjistruar në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve me numër rendor 20, në të cilën kërkoni informacion për: "Taksat e paguara nga kompania "Bankers Petroleum Albania" dhe "TransAtlantic Albania Ltd" që nga momenti në të cilin kanë lidhur marrëveshje me shtetin shqiptar deri në vitin 2016.", pas shqyrtimit të kërkesës, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", i ndryshuar, në nenin 24 dhe 25, përcakton në mënyrë të qartë autoritetet dhe rrethanat, të cilave Administratat Tatimore mund dhe duhet t'iu ofrojë, pas kërkesës me shkrim, informacion tatimor për tatimpaguesit, të administruar prej saj dhe konkretisht citojmë: *"Informacioni tatimor për tatimpaguesin, i administruar nga administrata tatimore, u ofrohet pa pagesë autoriteteve të përcaktuara në këtë nen, pas depozitimit të kërkesës me shkrim dhe kur verifikohen rrethanat e mëposhtme:*

- a) gjyqtarit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje civile, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore;*
- b) gjyqtarit apo prokurorit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje penale, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore;*
- c) Kontrollit të Lartë të Shtetit, vetëm për rastet, kur kërkesa e bërë është në funksion të kontrollit të kryer nga ky institucion ndaj administratës tatimore, në funksion të hartimit të rekomandimeve të veta;*
- ç) autoritetit të ngjashëm të huaj, me të cilin Kuvendi ka ratifikuar marrëveshje ndërkombëtare dhe informacioni kërkohet në kuadër të ekzekutimit të marrëveshjes;*
- d) autoritetit homolog të huaj ose autoriteteve vendase, me të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dy ose shumëpalëshe, me objekt shkëmbimin e informacionit;*
- dh)institucioneve të pavarura, të krijuara me ligj;*
- e) çdo autoriteti tjetër, sipas parashikimit të bërë me ligj të veçantë."*

Për sa më sipër, duke mos qenë subjekt i nenit 24, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", nuk mund t'ju ofrojmë informacion në lidhje me kërkesën e paraqitur nga ju.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin